



Prishtinë: 23 dhjetor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_675_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë;
- Dispozitat e Nenit 9 të Kodit të rregullimit–Kodi i planifikimit;
- Kërkesën e datës 01 tetor 2014 të dërguar nga KOSTT SH.A për komentim dhe kërkesën 25 nëntor 2014 të dokumentit Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2015-2024 për miratim për publikimin në faqen elektronike;

në seancën e mbajtur më 23 dhjetor 2014 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

I - Miratohet dokumenti Plani i Adekuacisë së Gjenerimit 2015-2024, dhe KOSTT mund të qarkulloj te palët dokumentin si dhe duhet të bëjë publikimin në faqen zyrtare elektronike.

ARSYETIM

Me datë 01 tetor 2014 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për komentimin dhe dhënien e pëlqimit për qarkullimin e dokumentit te palët, si dhe publikimin në faqen elektronike të **Planit të Adekuacisë së Gjenerimit 2015-2024**. Pas komentimit nga ZRRE dhe përfshirjes së komenteve në dokument KOSTT SH.A ka dërguar dokumentin final me kërkesën për miratim, si dhe qarkullim te palët dhe publikim në faqen elektronike zyrtare për të cilën ZRRE është pajtuar dhe lëshon këtë vendim.


II - Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.


III - Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar